

LIGJ
Nr. 3/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8402, DATË 10.9.1998,
“PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Kudo në ligj bëhen këto zëvendësime të termave:

- a) “Investitor” me “Zhvillues”.
- b) “Leje shfrytëzimi” me “Certifikatë përdorimi”.
- c) “Procesverbal kolaudimi” me “Akt kolaudimi”.
- ç) “Autoriteti përkatës i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit” me “Autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit”.
- d) “Autoriteti përkatës i planifikimit” me “Autoriteti përgjegjës i planifikimit të territorit”.
- dh) “Zyra e urbanistikës e njësisë vendore përkatëse” dhe “Autoriteti përkatës i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit të njësisë vendore” me “Autoriteti vendor i zhvillimit të territorit”.
- e) “Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” me “Agjencia Shtetërore e Kadastrës”.

Neni 2

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

Të gjitha objektet, të cilat kanë mbi 50 vjet që janë ndërtuar, i nënshtrohen procesit të auditimit teknik. Rregullat për mënyrën se si do të zbatohet auditimi dhe cilat do të jenë subjektet që do ta kryejnë atë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Me “auditim teknik” kuptohet aktekspertiza e thelluar që vlerëson gjendjen teknike të një objekti dhe kapacitetet e tij mbajtëse.”.

Neni 3

Neni 6 riformulohet si më poshtë:

“Neni 6

Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha:

- a) ndërtimet publike;
- b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë;
- c) objektet me akses publik.

Me “objekte me akses publik”, sipas këtij neni, do të kuptohen të gjitha objektet, ku, pavarësisht statusit të pronësisë së tyre, qytetarët kanë akses të lirë hyrjeje, si: kinema, teatro, stadione, markete etj.”.

Neni 4

Për të gjitha ndërtimet me vlerë mbi 100 milion lekë, zhvilluesi kryen dhe mban në fuqi, për të gjithë kohën e ndërtimit të objektit, sigurimin e detyrueshëm nga rreziqet për punimet e ndërtimit. Elementet e sigurimit të detyrueshëm dhe rregullat e sigurimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 2, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, dhe aktin nënligjor në zbatim të nenit 4, brenda 10 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 30.1.2020.